



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:143800

Datë: 02.09.2021

Numri i dokumentit: 02138677

P.nr.1018/2015

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit S.... A... nga fshati G....., Komuna e Gj....., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-së duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.nr.1710/2015 të datës 07.10.2015, duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe jashtë seance me datën 02.09.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.nr. PP.nr.1710/2015 e datës 07.10.2015 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit S.... A... nga fshati G... Komuna e Gj.... për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-së ngase tanimë kjo vepër penale është përfshirë në parashkrimin absolut të ndjekjes penale.
- II. E dëmtuaranë Gj.... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 08.10.2015, ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1710/2015 kundër të pandehurit S..... A.... nga fshati G....., Komuna e Gj..., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare gjeti se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është përfshirë në parashkrim absolut të ndjekjes penale ngase vepra penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 i KPRK-së është e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit ndërsa bazuar nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të KPRK-së ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 (dy) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme

deri në 1 (një) vit burgim ose dënim me gjobë gjithashtu sipas nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-ës thuhet se “Ndjekja penale ndalohe në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit” andaj edhe duke u bazuar në të lartcekurat si dhe faktin se vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri është kryer me datë dhe se deri më tani kanë kaluar mbi 4 vite nga koha e kryerjes së veprës penale gjykata erdhi në përfundim ndaj të pandehurit të lartcekur duhet të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale edhe përkundër faktit që gjykata ka ndërmarrë gjitha masat ligjore për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë.

Andaj, nga të lartcekurat dhe në bazë të nenit 358 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, nenit 106 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPP-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1018/2015 me datë 02.09.2021

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë brenda afatit prej 3 (tri) ditëve nga dita e pranimin të aktvendimit, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.